# NJOFTIM PËR PYETËSORIN STUDENTOR

I dashur student,

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligj Nr. 80/2015, Universiteti Politeknik i Tiranës organizon Pyetësorin Studentor për cilësinë e mësimdhënies.

Nëpërmjet pyetësorit, çdo studenti i jepet mundësia të shprehë perceptimin mbi procesin mësimor si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të universitetit shqetësime specifike.

Plotësimi i pyetësorit do të jetë i mundur duke filluar prej datës **16 – 22 Janar 2025** nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore.

**Link: http://bit-albania.com/**

Përgjigjet e pyetësorit përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre hartohen të dhëna statistikore për problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Analiza e të dhënave kryhet pas përfundimit të sesionit të provimeve, duke shmangur çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

Plotësimi i pyetësorit bëhet për çdo pedagog aktiv në semestrin aktual. Në llogarinë tuaj online do të shfaqet pyetësori vetëm për lëndët që frekuentoni si student i rregullt.

Universiteti Politeknik e vlerëson maksimalisht mendimin tuaj dhe ju nxit të merrni pjesë në këtë proces. Duke punuar së bashku, UPT mund të vijojë traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

**Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - UPT**

***Shënim:***

- *Për problematika në plotësimin e pyetësorit apo për pasaktësi në të, jeni i lutur t'i drejtoheni sekretarisë mësimore ose zyrës për sigurimin e cilësisë në fakultetin tuaj*
- *Për probleme të tjera lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT mund të kontaktoni me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/*

# PYETËSORI STUDENTOR

# INFORMACION MBI MARRJEN E FJALËKALIMIT PËR HERË TË PARË NË SEKRETARINË MËSIMORE ONLINE

Me qëllim pjesëmarrjen në Pyetësorin Studentor për Vitin Akademik 2024-2025, Semestri I, studentët e vitit të parë dhe ata që nuk e kanë përdorur më parë Sekretarinë Mësimore Online duhet të aksesojnë Portalin në linkun:

http://bit-albania.com/ (klikoni UPT)

Për marrjen e fjalëkalimit për herë të parë, ndiqni instruksionet në videon tutorial (shih ilustrimin më poshtë):




**KLIKO KËTU PËR TË PARË VIDEON**

***Shënim:***

- *Për problematika në marrjen e fjalëkalimit, jeni i lutur t'i drejtoheni sekretarisë mësimore pranë fakultetit tuaj.*
- *Për probleme të tjera lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT mund të kontaktoni me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë:* https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/